



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 dhjetor 2023
Nr.ref.: RK 2302/23

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI133/23

Parashtrues

Musli Mehmetaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar, dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Musli Mehmetaj (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Beqir Mehmetaj nga fshati Gllarevë, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilin akt të autoritetit publik e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar dhe qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 qershor 2023, përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 qershor 2023, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
8. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KI133/23], caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI133/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi Peci, anëtarë.
9. Më 10 korrik 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës në mënyrë që të procedojë tutje me rastin, kërkoi nga ai **(i)** që të plotësojë formularin zyrtar; **(ii)** t'i specifikojë dhe bashkëngjisë vendimin/et e kontestuara para Gjykatës; **(iii)** t'i specifikojë qartë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe t'i elaborojë në detaje arsyetimin e tyre; si dhe **(iv)** autorizimin specifik dhe dokumentet e tjera relevante.
10. Gjykata nuk pranoi një përgjigje nga përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës brenda afatit të përcaktuar në shkresën e dorëzuar, pavarësisht faktit se shkresa e Gjykatës është pranuar më 12 korrik 2023.
11. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtë.

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Gjykata që në fillim të shqyrtimit të fakteve, vëren se emri i Musli Mehmetajt, në emër të të cilit përfaqësuesi i pretenduar ka paraqitur kërkesën në fjalë, figuron edhe në kërkesën KI 117/22, në të cilën Gjykata tashmë ka vendosur. Megjithatë, Gjykata nuk do të lëshohet në shqyrtim të mëtejme nëse bëhet fjalë për të njëjtin person për arsye se në shkresat e lëndës nuk ka informacione të hollësishme, në bazë të të cilave do të nxirrte ndonjë përfundim lidhur me identitetin. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata do të shqyrtojë në vazhdim vetëm faktet e cekura në letrën që përfaqësuesi i supozuar i dorëzoi Gjykatës.
13. Përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës, kishte dorëzuar vetëm një shkresë në të cilën kishte theksuar se kanë kaluar 10 vite prej se djali i tyre Musli Mehmetaj është duke e vuajtur dënimin me burgim, dhe në lidhje me këtë çështje nuk kanë marrë asnjëherë ndonjë sqarim nga gjykatat e rregullta.
14. Meqënëse, në shkresat e lëndës përfaqësuesi i pretenduar parashtruesi i kërkesës nuk e kishte plotësuar formularin zyrtar të kërkesës, nuk kishte specifikuar se cilin akt/vendim, procedurë apo veprim procedural të gjykatave të rregullta po kontestonte dhe nuk kishte bashkëngjitur dokumentet e tjera relevante, Gjykata i kishte dërguar një shkresë dhe kishte kërkuar nga i njëjti që t'i dorëzojë dokumentet shtesë të lartëcekura, në mënyrë që të procedojë tutje me rastin.
15. Lidhur me këtë, Gjykata nuk pranoi asnjëherë ndonjë përgjigje apo shkresë nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës në kërkesën e parashtruar para Gjykatës, meqënëse nuk kishte specifikuar se cilin akt/vendim të gjykatave, procedurë apo veprim procedural të gjykatave të rregullta po kontestonte, si pretendim të vetëm dhe të pasqaruar në detaje e ka *“ E nderuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës, tash e 10 vite jemi duke u përballur me vuajtjen e dënimit të djalit tonë Musli Mehmetaj dhe ka 6 vite në gjdo derë të gjykatave dhe asnjëherë nuk e kemi marrë as një sqarim nga sistemi i drejtësisë. (...)”*
17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“Kërkojmë nga ju si Gjykatë Kushtetuese që sa më parë të të na jepni përgjigje, sepse ne si familje dhe djali jonë jemi lodhur nga këto pritje të gjata duke mos marrë as edhe një përgjigje as për mirë e as për keq. Andaj kërkojm nga ju si gjykat të na mundësohet lirimi i djalit tonë sa më parë sepse ka kaluar mbi 10 vite në burg.”*
18. Në këtë drejtim, edhe pse Gjykata i'u kishte drejtuar me një shkresë parashtruesit të kërkesës, lidhur me çështjen se cili është akti/vendimi që po e kontestonte dhe të specifikonte shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe të arsyetonte të njëjtat, Gjykata nuk pranoi ndonjë përgjigje apo shkresë nga parashtruesi i kërkesës, e që rrjedhimisht Gjykata nuk e ka të njohur ndonjë pretendim tjetër të parashtruesit.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregullorja e punës

Rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

[...]

2. *“Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

(c) autorizimin për përfaqësim;

(d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet;

(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;

(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;

(g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës;

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”

[...]

Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

“[...]

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Së pari, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutës dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Megjithatë, përtej kritereve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihen në nenin 21 dhe 48 të Ligjit, që përcakton:

Neni 21
(Përfaqësimi)

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Përveç kësaj kritereve të lartcekura, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e nenit rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës ku parashihet se kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë edhe : (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësim; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
23. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parashihet se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Në rastet kur palët përkatëse nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë apo përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës për të plotësuar apo qartësuar kërkesën dhe e njëjta sërish mbetet e paplotë ose e paqartë, bazuar në rregullin 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër.
24. Në rastin konkret, duke u bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata rikujton se kërkesën e përfaqësuesit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 14 qershor 2023, por e njëjta përbëhej vetëm nga një letër, në të cilën nuk ishte specifikuar akti i autoritetit publik i cili po kontestohet para Gjykatës, nuk ishin specifikuar nenet e Kushtetutës për të cilat po pretendohet për shkelje dhe arsyetimi i pretendimeve për ato shkelje, mungonte përmbledhja e fakteve, mungonte autorizimi specifik që dëshmonte se Beqir Mehmetaj e përfaqëson Musli Mehmetaj në procedurën para Gjykatës Kushtetuese dhe nuk ishin bashkëngjitur në kërkesë asnjëra nga aktet/vendimet e ndodnjë autoriteti publik që kishte të bënte me rastin e parashtruesit të kërkesës. Në këtë situatë, marrë parasysh faktin e mungesës së formularit zyrtar të plotësuar dhe dokumenteve relevante të cekura më lartë, Gjykata më 10 korrik 2023, e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në mënyrë që të procedojë tutje me rastin, kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë në Gjykatë: **(i)** Formularin zyrtar të plotësuar, në të cilin i njëjti do të duhej të specifikonte aktin e autoritet publik që po kontestonte, shkeljet e

- pretenduara të neneve të Kushtetutës dhe arsyetimin e tyre; **(ii)** Aktin/vendimin që i njëjti konteston para Gjykatës dhe vendimet e tjera që kanë të bëjnë me rastin e parashtruesit; si dhe **(iii)** dokumentet e tjera relevante së bashku me autorizimin specifik që dëshmon se i njëjti përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurën para Gjykatës Kushtetuese.
25. Bazuar në fletë-kthesë, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka pranuar shkresën e Gjykatës më 12 korrik 2023, por i njëjti nuk ka dorëzuar në Gjykatë ndonjë përgjigje, shkresë apo dokument të kërkuar.
 26. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se është treguar mjaftë e qartë në kërkesën me të cilën iu është drejtuar përfaqësuesit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës për të dorëzuar aktin/et e kontestuar/a nga parashtruesi i kërkesës, formularin e plotësuar, autorizimin specifik dhe dokumentet e tjera relevante që i parasheh Ligji dhe Rregullorja e Punës së Gjykatës. Megjithatë, Gjykata vëren se përfaqësuesi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës, edhe pse ka pranuar shkresën e Gjykatës, i njëjti ka shpërfillur kërkesat e Gjykatës dhe nuk ka dorëzuar asnjërën nga dokumentet e kërkuara.
 27. Për më tepër, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar nga një person tjetër, i cili pretendon të jetë i autorizuar për të përfaqësuar Musli Mehmetaj në Gjykatë, dhe i cili, përkundër kërkesës së Gjykatës të 10 korrikut 2023, nuk ka dorëzuar autorizimin specifik i cili do të vërtetonte se i njëjti ishte autorizuar nga Musli Mehmetaj për ta përfaqësuar këtë të fundit para Gjykatës.
 28. Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm dhe dokumenteve të tjera relevante në Gjykatë, bazuar në nenin 21 të Ligjit dhe rregullit 25 të Rregullorës së Punës, i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë.
 29. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson, se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar, përkundër kërkesave të Gjykatës, nuk ka dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, [KI25/21](#), parashtrues, [Ymer Koro, si përfaqësues i pretenduar i K.Lj. dhe K.B.](#), Vendim për refuzim të kërkesës, i 21 korrikut 2021; dhe [KI137/20](#), parashtrues, [Naser Peci, si përfaqësues i pretenduar i S.B.](#), Vendim për refuzim të kërkesës, i 17 dhjetorit 2020).
 30. Gjithashtu, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtëpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit të kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesave (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës: [KI121/21](#), parashtrues [Bajram Hasani](#), Vendim për refuzimin e kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; [KI135/21](#), parashtrues [Isuf Musliu](#), Vendim për refuzimin e kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe [KI101/21](#), "[N.T.Sh Morina B](#)", Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
 31. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak të mungesës së autorizimit formal për përfaqësim dhe moskompletimit të kërkesës me dokumentacionin mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit

dhe me rregullin 25 (2) (c) (d) (e) (f) (g) (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 25 (2) (c) (d) (e) (f) (g) (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 nëntor 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani